



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 1 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 43 prot., datë 04.01.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023, në bazë të të dhënave të përcjella nga gjykatat rezultojnë në total 73 (shtatëdhjetë e tre) çështje me palë gazetarët ose punonjësit e medias, më konkretisht:

- Pranë **Gjykatës së Lartë** rezulton që, për periudhën e kërkuar ka patur në total 2 (dy) çështje me palët e mësipërme, nga të cilat 1 (një) është çështje penale, e cila tashmë është shqyrtuar dhe për të cilën është dhënë vendim që konsiston në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës mes gjykatave duke përcaktuar gjykatën kompetente për zgjidhjen e çështjes. Ndërsa, çështja e dytë e cila është çështje administrative ndodhet aktualisht në fazë studimi.
- Pranë **Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** rezulton që, për periudhën e kërkuar ka patur në total 28 (njëzetë e tetë) çështje me palët e mësipërme, nga të cilat 21 (njëzetë e një) janë çështje civile dhe 7 (shtatë) janë çështje penale. Aktualisht këto çështje janë në fazë shqyrtimi.
- Pranë **Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë** rezulton që, për periudhën e kërkuar ka patur 38 (tridhjetë e tetë) çështje civile, të cilat janë aktualisht në gjykim.
- Pranë **Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë** rezulton që, për periudhën e kërkuar ka patur 1 (një) çështje me palët e mësipërme, e cila aktualisht është e pezulluar.
- Pranë **Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan** rezulton që, për periudhën e kërkuar ka patur 1 (një) çështje me palët e mësipërme, e cila aktualisht është në përpunim.
- Pranë **Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës** rezulton që, për periudhën e kërkuar ka patur (1) një çështje penale me palët e mësipërme, e cila është në fazë shqyrtimi.

- Pranë **Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë** rezulton që, për periudhën e kërkuar ka patur (1) një çështje civile me palët e mësipërme, e cila është në fazë gjykimi dhe ende nuk ka datë të planifikuar për këtë çështje.
- Pranë **Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë** rezulton që, për periudhën e kërkuar ka patur (1) një çështje me palët e mësipërme, e cila është në fazë gjykimi.

Ndërsa pranë **Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Korçë, Berat, Fier, Vlorë, Sarandë, Kukës, Dibër, Shkodër dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje** nuk rezulton të ketë patur asnjë çështje gjyqësore me palë gazetarët ose punonjësit e medias, për periudhën e kërkuar.

Ndërsa, lidhur me kërkesën tuaj për informacion nëse institucioni ynë ka ndërtuar një regjistër të dhënash me palë gazetarët ose punonjësit e medias ju informojmë se, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk disponon një regjistër të tillë.

Për sa më sipër, sjellim në vëmendjen tuaj se, bazuar në nenin 92 pika 2 shkronja “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Këshilli, në cilësinë e institucionit përgjegjës për zhvillimin ose pjesëmarrjen në zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në gjykata ka ndërmarrë disa masa lidhur me evidentimin e çështjeve gjyqësore me këto palë.

Në këtë aspekt, janë realizuar zhvillime shtesë në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS dhe ARKIT me qëllim evidentimin e çështjeve ku si palë ndërgjyqëse janë gazetarë apo përfaqësues mediash për objekte që lidhen me garantimin e lirisë së shprehjes. Zhvillimi është duke u konfiguruar në gjykatat e të gjitha niveleve dhe për të gjitha çështjet të cilat regjistrohen rishtazi me palë gazetarë apo përfaqësues mediash, tanimë mund të gjenerohet dhe raporti mbi numrin e çështjeve të mbartura (vitin e ardhshëm), numrin e çështjeve të regjistruara të reja, numrin e çështjeve në gjykim, statusi i çështjes, mënyra e përfundimit dhe informacion nëse çështja është ankimuar apo jo.

Konkretisht, në portalin gjykata.gov.al tek rubrika “Çështjet gjyqësore”, në nënrubrikën e saj “Çështje civile” tek fusha “Lloji i çështjes” në listën e kategorive të çështjeve gjyqësore që përmban kjo fushë, është shtuar kategoria e çështjes e emërtuar “Padi me palë Gazetarë/Përfaqësues Mediash”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!